



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përftimi i kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler AG mbi disa shoqëri.

Me shkresën Nr.250 Prot., datë 17.04.2018, pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi i përqendrimit të realizuar si pasojë e përfimit të kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler, në ndërmarrje të përbashkëta (joint-venture) me funksione të plota. BMW dhe Daimler AG janë dy prodhues automjesh dhe kanë për qëllim të përfitojnë kontrollin e përbashkët në 6 sipërmarrje të përbashkëta joint-venture duke bashkuar kështu shërbimet e ofruara nga palët në pesë fusha të ndryshme biznesi si: qiradhënia e makinave, shërbimi taksitë nëpërmjet aplikacioneve, shërbime parkimi, shërbimi i karikimit të automjeteve si dhe shërbime të tjera me kërkesë të klientëve.

Palët pjesëmarrëse në transaksion:

Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft (BMW) është një shoqëri aktive në prodhimin e motoçikletave dhe automobilave me seli në Mynih Gjermani. Përveç zhvillimit, prodhimit dhe marketimit të këtyre automjeteve, BMW gjithashtu ofron shërbime financiare për klientë privatë apo biznese. BMW është një nga prodhuesit më të suksesshëm të makinave për pasagjerë dhe motoçikletave në nivel botëror dhe ofron gjithashtu shërbime Premium në fushën e transportit individual.

Daimler AG, me të gjithë nënndarjet e tij¹ është një shoqëri e listuar sipas ligjit gjerman, me seli qendrore të regjistruar në Stuttgart, Gjermani që operon në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen kryesisht të makinave për pasagjerë dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbim financiar për automjete, duke përfshirë financimin, qiranë financiare, sigurimin dhe shërbime për menaxhimin e flotave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

¹ Ndarjet e aktivitetit të Daimler janë veturat Mercedes-Benz; kamionët Daimler, Fugonët Mercedes Benz, Autobusët Daimler dhe Shërbimet Financiare Daimler

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.